



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.1/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, duke vepruar sipas kërkesës së palës A Sh [redacted] nga Gjilani, të datës 29.12.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarës E [redacted] E [redacted]-T [redacted], gjyqtare në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, me datë 12.01.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

REFUZOBET e pabazuar kërkesa e palës A Sh [redacted] nga Gjilani, e datës 29.12.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarës E [redacted] E [redacted]-T [redacted], gjyqtare në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës, A Sh [redacted] nga Gjilani, më datë 29.12.2023 ka paraqitur ankesë urgjente ndaj gjyqtarës E [redacted] E [redacted]-T [redacted], me pretendimet ankimore se e njëjta i ka mohuar të drejtën në qasje të dokumenteve publike, përkatësisht nuk i ka dorëzuar me kohë ankesën e palës së kundërt (të paditurit H [redacted] Sh [redacted]) ndaj aktgjyqimit C.nr.274/15, përkundër se më datë 18.12.2023 ka parashtruar kërkesë urgjente që t'i dorëzohet ankesa në fjalë, e njëjta i është dorëzuar më datë 29.12.2023. Përveç kësaj, ka theksuar se ka pranuar thirrjen për shqyrtim gjyqësor për seancën e caktuar më datë 10.01.2024, duke konsideruar se në këtë mënyrë nuk është arritur efektiviteti i dorëzimit të dokumenteve konkretisht ndërmarrjes së veprimeve procedurale. Nga këto arsye ka vlerësuar se mos dorëzimi me kohë i shkresave të lëndës përbën shkelje të qëllimshme të ligjit nga ana e gjyqtarës, duke kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj të njëjtës.

Si provë ka bashkëngjitur kërkesën e datës 18.12.2023 për dorëzimin e ankesës ndaj aktgjyqimit në fjalë.

Kryetari i gjykatës, pas analizimit të pretendimeve të palës ankuese dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Kërkesa e palës A Sh [redacted] është e pabazuar.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës ka ardhë duke u bazuar në faktin se pala A Sh [redacted] ka kërkuar t'i dorëzohet një dokument (këtu ankesa ndaj aktgjykimit nga pala e kundërt) nga gjyqtarja e çështjes dhe e njëjta i ka dorëzuar dokumentin palës, duke vepruar në këtë mënyrë sipas kërkesës së tij.

Kryetari i gjykatës vlerëson se nuk kemi të bëjmë me mohim të së drejtës në qasje në dokumentet publike për shkak të faktit se kërkesa për dokument është proceduar më datë 18.12.2023, ndërsa i është dorëzuar të njëjtit më datë 29.12.2023, pasi afati brenda të cilit është përcjellë ky dokument deri te pala është afat që i përgjigjet drejtë natyrës së shkresës dhe vëllimit të parashtrësive e lëndëve që gjenden në gjykatë, përkatësisht në zyrën e gjyqtarës E [redacted] E [redacted]-T [redacted]. Përkundër faktit se pala e ka emërtuar kërkesën e tij të natyrës urgjente, me Ligjin për Procedurën Kontestimore janë përcaktuar shprehimisht se cilat kërkesa paraqesin natyrë urgjente të veprimit, aq më tepër bëhet fjalë për ankesën e datës 26.06.2021, të paraqitur kundër aktgjykimit C.RR.274/15, dt.27.11.2020.

Përfundimisht, kryetari i gjykatës ka gjetur se nuk është përmbushur asnjë nga pikat e parapara në nenin 5, paragrafi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Gjyqtar, por vlerëson se z. A Sh [redacted] si palë në këtë procedurë ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës me ankesa të kësaj natyre, prandaj bazuar në nenin 9 paragrafi, 6 të po të njëjtit ligj, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës
Vahar Sahu

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. KGJK-së,
3. Dosjës së lëndës.